



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2403/1 prot

Datë 03.08.2026

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-85450-05-13-2026, me objekt: “*Furnizimi i Shërbimit të lavanderisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me fond limit 296,976,783 lekë (pa tvsh), me datë të mbylljes së pranimi të kërkesave për pjesëmarrje 19.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK me NIPT (L01703501S) dhe adresë: Fshati Xhafzotaj, godinë 1 katëshe, ngjitur me tregun rural të fruta perimeve, Xhafzotaj, Durrës.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/7097, datë 30.07.2026 dhe me nr. protokolli 2403/2026 datë 31.07.2026 e operatorit ekonomik “Univers Servis” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-85450-05-13-2026, me objekt: “*Furnizimi i Shërbimit të lavanderisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me fond limit 296,976,783 lekë (pa tvsh), me datë të mbylljes së pranimi të kërkesave për pjesëmarrje 19.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK kundërshton me anë të ankesës nr. A/2026/7097, datë 30.07.2026 dhe me nr. protokoli 2403/2026 datë 31.07.2026. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

1.Nuk plotëson kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.7 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim dhe Shtojcës 8 Specifikimet Teknike për Materialet e Buta që do furnizohen në Spitalin e Beratit, për këto arsye:

a) Nuk ka plotësuar të dhënat e kërkuara në tabelën sipas pikës 2.3.7 në lidhje Certifikimet CE të Akredituara për produktet e materialeve të buta sipas listës të artikujve të kërkuara shprehimisht në tabelën sipas pikës 2.3.7 dhe Shtojcën 8 të DST Specifikimeve Teknike. Nuk ka paraqitur/plotësuar deklaratimet në tabelë mbi Certifikimet CE të Akredituara për materialet e buta për cilat është kërkuar Certifikim Specifik në DST.

Arsyetimi

Konkretisht në tabelën sipas pikës 2.3.7 kërkohet: Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë të përcaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme:

QSRB

Nr. Emertimi i produktit Vendi i origjinës Skede teknike/katalog

Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar

1-31 Artikujt

Në bazë të Dokumentave të Tenderit pika 2.3.7 referon qartë detyrimin për plotësimin në tabelë të Certifikimeve të Cilësisë CE të Akredituar për artikujt e përcaktuar në Specifikimet Teknike me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë nëse produktet i plotësojnë Specifikimet Teknike të materialeve që do të furnizohen në Spitalin e Beratit në kuadër të kontratës të shërbimit të lavanderisë.

Referuar dokumenteve të paraqitura në SPE nga Univers Servis sh.p.k, ne tabele është plotësuar vetëm emërtimi “Certifikatë Konformiteti” dhe nuk specifikohet cilat “Certifikime të Cilësisë CE” konkrete plotëson seicili artikull dhe nuk evidenton nëse kemi të bëjmë me “Certifikime Cilësie CE të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara” sikurse është vendosur kusht në kërkesën 2.3.7 edhe kërkesa. Pra rezulton se tabela 2.3.7 nuk është plotësuar me të dhënat e kërkuara dhe subjekti nuk e plotëson kërkesën.

Sqarojmë se referuar fakteve në dokumentet e dorëzuara në SPE, Operatori Ekonomik UNIVERS SERVIS në lidhje me pikën 2.3.7 të KVK, ka qenë i qartë për kuptimin e kërkesës për kualifikim,

pasi ka paraqitur Certifikimet OEKO-TEX si dhe Certifikatën CE EN ISO 20347:2021 për artikullin “pantofla”, lëshuar nga organe të Vlerësimit të Konformitetit të Shtetit Italian, por nuk ka përmbushur detyrimin e plotësimit në tabelë të Certifikimeve CE të akredituara, për të gjitha artikujt për të cilët sipas Shtojcës 8 të DST kërkohen Certifikata CE të posacme, pasi në tabelën 2.3.7 mungojnë krejtësisht deklarami për Certifikimet konkrete CE që përmbajnë artikujt DYSHEK, DYSHEK NEONAT, JORGAN, BATANIJE, CARCAF I I SIPËRM NEONAT DHE CARCAF I POSHTËM NEONAT.

2.Nuk plotëson dhe nuk vërteton me dokumentacion kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.4 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, për këto arsye:

Arsyetimi

Në pikën 2.3.4 Kërkesat e Vecanta për Kualifikim është kërkuar “Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë, e cila të përfaqësojë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë: -SSH EN 14065:2016 mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Për këtë pikë kualifikuese OE Univers Servis paraqiti certifikatën EN ISO 14065:2016, lëshuar nga një subjekt letonez. Në kuadër të kompetencave për verifikimin e informacionit të ofertës nga OE pjesëmarrës, KVO kreu verifikimin e Certifikatës në faqen zyrtare të Entit Kombëtar për Akreditimin në Letoni “LATAK”, nga ku rezultoi se subjekti që ka lëshuar Certifikimin në emër të shoqërisë Univers Servis sh.p.k, nuk është i Akredituar për Certifikimin EN ISO 14065:2016 me objekt “Shërbime Lavanderi 2016, Mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit, pra Operatori Ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore për Certifikimet e kërkuara në procedurën e prokurimit, për sigurimin e standarteve të cilësisë sipas Nenit 79 pika 1 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”k:u përcaktohet: Neni 79 pika 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”

3.Nuk plotëson dhe nuk vërteton me dokumentacion kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.8 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, për këto arsye:

Arsyetimi

Në pikën 2.3.4 Kërkesat e Vecanta për Kualifikim është kërkuar 2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit në Termat e References shtojca 10 e DST:

-Material i kontaminuar”

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.

-Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”

-Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformitetit ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.

II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalor”

III. Tabellen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

Për plotësimin e kësaj kërkesë Subjekti “Univers Servis” ka paraqitur në SPE dokumentin Deklaratë Konformiteti, për produktet kimike larëse, lëshuar nga subjekti furnizues me origjinë Itali, dokument i cili nuk e plotëson kërkesën pasi referuar pikës 2.3.8 e Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, nuk kërkohet Vetdekalrim i subjekti prodhues/furnizues por kërkohet shprehimisht Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh që do të përdoren për procesin e larjes kimike.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 03.08.2026.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Gjergj Mersini**

**Anëtar
Edvin Simo**

**Anëtar
Nertil Kanina**

**Kryetar
Ismail Shehu**